

PARAJA E PISËT RRËNON INDUSTRIJË

Sipas shoqatës së eksportuesve shqiptarë, prej nëntorit të vitit 2023 deri në nëntor të vitit 2024, afro 10.000 punëtorë të sektorit fason janë flakur më rrugë dhe me dhjetra fabrika, disa edhe me një traditë mbi njëzetvjeçare në industrinë tekstile në Shqipëri, kryesisht në qarqet më të varfëra të veriut të vendit, janë mbyllur. Arsyeja është e thjeshtë: forcimi artificial i valutës vendase kundrejt valutave evropiane për shkak të vërshimit të parasë së pisët, të korrupsionit dhe të ardhurave sezonale në turizëm, kanë dëmtuar seriozisht të ardhurat e industrisë, krizën e së cilës e paguajnë punëtorët. Këta 10.000 punëtorë, shumica dërmuese e të cilëve janë vajza dhe gra, për fat të keq, të papuna, tanimë edhe më të varfëra dhe me shanse të ulëta për ripunësim, do të ngujohen në rolin e amvisës në periferitë e vendit, duke u ekspozuar edhe më të pafuqishme të përballë izolimit, pafuqisë dhe rrezikut të dhunës me bazë gjinore. Sepse papunësia është mbi të gjitha humbje e pavarësisë. Karshi kësaj situatë, qeveria e amnistimit të parave të pisëta, qëndron këmbëkryq dhe pa asnjë plan konkret për të parandaluar rritjen e përmasave të katastrofës sociale. ■

PUNA NË TË ZEZË

Protesta e pensionistëve, përveçse e shkundi qeverinë Rama, e bëri atë edhe të reflektonte mbi epideminë e punës në të zezë. Sipas të dhënave, 1 në 2 punëtorë në Shqipëri figurojnë në të zezë. Por reflektimi i kryeministrit Rama, i cili doli në media për t'ua hedhur fajin njerëzve të punës dhe biznesit të vogël për pensionet e ulëta në vend, nuk rezulton të jetë i sinqertë, por vetëm një manovër demagogjike për të shpëtuar problemit të pensionistëve. Sepse, sipas planifikimeve të qeverisë për vitin 2025, pavarësisht kërcënimeve të kryeministrit, parashikohet e njëjta masë punëtorësh kontribues për skemën pensionale. Mjafton ky fakt për të provuar se qeveria nuk e ka seriozisht ndryshimin e situatës as për klasën punëtore dhe as për atë të pensionistëve, duke e mbajtur nivelin e informalitetit dhe të varfërisë në nivele tepër të larta. ■

LUMTURIA NË PIKËPYETJE

Sipas një studimi të fondacionit "Friedrich-Ebert-Stiftung", ku 680 të rinjë të moshës 14-29 vjeç janë pyetur mbi çështje personale si lidhjet romantike, martesë, bashkëjetesa etj, ka nxjerrë disa rezultate interesante për të vështruar panoramën e përgjithshme të gjendjes emocionale dhe mendore të rinisë në vend. Për shembull, nga këta 680 të rinj, 75% prej tyre, pra 3 në 4 të rinj nuk janë në asnjë marrëdhënie romantike dhe vetëm 11.5% prej tyre janë të martuar. Po ashtu, sipas studimit, këta të rinj nuk kanë më besim tek hapësira publike dhe pjesa më e madhe e tyre janë të paangazhuar edhe në aktivitete me natyrë sociale dhe vullnetare, duke u ngujuar në zhguallin e qelizës familjare. Që do të thotë se të rinjtë shqiptarë po përjetojnë një situatë ekstreme pasigurie shpirtërore dhe ekonomike, me frymën e pesimizmit dhe mosbesimit që ka okupuar të gjitha sferat e shoqërisë. Përqindje të tilla individualizmi dhe rënie të besimit tek shoqëria janë këmbana alarmi për ardhmërinë e vendit tonë. ■



Punëtorët e hekurit në pushim, pikturë vaji nga piktori amerikan Thomas Anshutz (1851–1912)

Në këmbët e drejtësisë: zëri i grave të "Alba Shoes Group"

Nga Ariola Zeneli

Në qytetin e Vlorës, një grup grash të guximshme dhe të papërkulura të kompanisë "Alba Shoes Group" kërkuar drejtësi për veten e tyre. Ato mbajtën pankarta që shpreheshin me fjalë të thjeshta dhe të fuqishme, kërkesa për të drejta që lidhen me sigurimet shoqërore dhe vonesat e pagave. Protesta, që ishte e katërta në radhë, nisi me bojkotimin e punës dhe vazhdoi me përballjen e tyre me Inspektoratin e Punës. Ato kërkuar jo vetëm zgjidhje, por njohjen e mundit të tyre të padukshëm, që nuk mund të matet vetëm me shifra. "Sigurimet shoqërore janë të rëndësishme për ne," u shprehen ato me një zë të qartë, "sepse janë si shenja e kujdesit të një shoqërie për çdo individ, si një mburojë që na mbron kur ne kemi nevojë për më shumë se kaq."

Gratë kërkuar rregullimin e pagesave për orët shtesë dhe për ditët e festave, si dhe një turn që do të mundësojë punën gjatë shtunave. Po ashtu, ato kërkuar që sigurimet shoqërore të paguhen rregullisht, pasi shumë prej tyre kanë hasur probleme kur kanë kërkuar shërbime shëndetësore apo kanë pasur nevojë për pagesa me këste.

Një tjetër shqetësim i punonjëseve ishte zhvendosja e filialit të Vlorës në Nartë, një zonë më e largët, që do të krijonte vështirësi për ato që kanë fëmijë dhe përgjegjësi familjare. Ky vendim ka shtuar tensionet dhe ka nxitur reagimin e grave. Pas takimit me drejtuesit e kompanisë, janë bërë disa premtime për përmirësimin e kushteve të punës. Ata kanë premtuar që sigurimet shoqërore do të shlyhen deri në fund të muajit dhjetor, dhe se do të rregullohen vonesat e pagave, duke përfshirë dy muajt e humbur. Gjithashtu, do të negocionohet për pagesën e orëve shtesë dhe ditëve të festave.

Në fund të ditës, përtej fjalëve dhe propozimeve, ajo që mbetet është lufta e përditshme për të pasur një vend të denjë në shoqëri. Kjo është historia e grave të "Alba Shoes", një histori e thjeshtë, por që na kujton se, kur lufton me guxim dhe dinjitet, çdo hap i bërë është një hap më pranë drejtësisë. ■



Kubizmi i Isuf Sulovarit

Isuf Sulovari (1934-2006) është një nga piktorët më modernë të arteve pamore shqiptare. Anipse një piktor i realizmit socialist, stili i tij, i devijuar nga skematizmi i thatë dhe me ndikime të mëdha nga piktorë kubistë si francezi F. Leger apo piktorë meksikanë të shek XX, e bën padyshim një autor original të traditës sonë artistike.



Tre Poezi nga Zef Zorba

Zef Zorba (1920-1993) është një nga emrat më të veçantë dhe autentikë të poezisë moderne shqipe. I konsideruar si hermetik dhe zë i pazakontë i letrave shqipe, ai shkroi në kushtet e anonimatit të plotë, larg publikut dhe me gjasë, pa shpresën e botimit.

Një gozhdë

Një gozhdë e futur thellë në mur, një gozhdë e futur thellë në mur, një gozhdë e futur.
Një gozhdë e ngulur thik në mur, një gozhdë e ngulur thik në mur, një gozhdë e ngulur...
Një gozhdë e mbetur thatë në mur, një gozhdë e mbetur thatë në mur, një gozhdë e mbetur.
e ngulur thik ...
e futur thellë ...
e mbetur thatë ...

Mbas varrimit

Shiu s`po pushon sot nadje.
Dy djem të fillores,
sytë duke picrruar lexojnë
në shtyllë të telefonit në udha-kryq
letrën me anë të zeza.
“Uuu...! ai plaku...”
(çon trinën e dorës nën hundë
më i madhi.)
Buzë mbrëmjes hëna e plotë
shkëlqen e pa- mârre.
Ca gra në jazë
kalojnë nën ballkon
e gazin që i plasë
përpiqen m`e fashitë
mbas rubash të zeza.

Shtëpizat

Për njëra tjetrën strukur
shtëpizat,
të dala boje përkulen,
mërdhasin
me sy të ngulitur në horizont.
Është qielli plot pranverë.
Unë s`drua
Edhe po të më priret prej hallesh
një brengë.
(Mos ndoshta kjo erë
ma zgjon falisur
për reshje përtëritëse?
Kesh bahemi fëmi
edhe një herë!)

Organizohu!

tel: 0692570076
e-mail: organizohu@gmail.com

DIMRI I MADH I PENSIONISTËVE

